



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 qershor 2017
Nr. ref.:RK 1093/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI130/16

Parashtrues

Hamdi Ibrahim

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të
Kosovës, KGJK/nr. 74/2016, të 6 korrikut 2016**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hamdi Ibrahim nga Podujeva (në tekstin e mëtejme: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK), KGJK/nr. 74/2016, të 6 korrikut 2016, i cili i është dorëzuar më 12 korrik 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të lartpërmendur të KGJK-së, me të cilin, siç pretendohet, janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të garantuara me nenin 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 10 [Liria e shprehjes] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Gjithashtu, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata): *“... të caktohet masa e përkohshme ashtu që Vendimi i KGJK-së i dt. 6.07.2016 të lihet jashtë fuqisë deri në marrjen e vendimit definitiv nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës”.*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 29, 54 dhe 55 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 11 nëntor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 12 dhjetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Bekim Sejdiu (gjyqtar) dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (gjyqtare).
8. Më 20 dhjetor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Këshillit Gjyqësor të Kosovës një kopje të kërkesës.
9. Më 1 janar 2017, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë plotësimin e kërkesës së 11 nëntorit 2016.
10. Më 27 mars 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 29 qershor 2015, parashtruesi në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë e dha një intervistë në një stacion radio-televiziv, në të cilën paraqiti qëndrimin e tij dhe komentoi punën e Prokurorisë së Shtetit të Kosovës.

12. Më 4 dhjetor 2015, Zyra e Prokurorit të Shtetit i paraqiti Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KDKGJK) ankesë me të cilën e ngarkoi parashtruesin për sjellje të pahijshme sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, që ka të bëjë me shkeljen e Kodit të Etikës për Sjellje Profesionale për gjyqtarë.
13. Më 31 mars 2016, KDKGJK mori Vendimin KD. nr. 04/2016, me të cilin e gjeti parashtruesin përgjegjës për sjellje të pahijshme dhe rrjedhimisht i shqiptoi masën disiplinore qortim. Në vendimin e KDKGJK-së thuhet:

“Komisioni konstaton se me deklaratën e bërë kryetari Ibrahimimi me datë 29 qershor 2015, në televizionin Koha Vision, në emisionin Puls, i ka tejkualuar kompetencat e tij si kryetar i gjykatës, kompetenca këto të përcaktuara me nenin 24 pika 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës”.

14. Më 27 prill 2016, parashtruesi paraqiti ankesë në KGJK kundër vendimit të KDKGJK-së, të 31 marsit 2016.
15. Më 6 korrik 2016, KGJK mori vendimin me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit me arsyetimin:

“Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në bazë të nenit 41 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës nr. 03/L-223, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vendimin e goditur, pretendimet ankimore dhe pas kësaj, gjeti se ankesa e kryetarit/gjyqtarit Hamdi Ibrahimimi është e pabazuar.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *“me këto vendime shkelet e drejta e lirisë së shprehjes e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës për të adresuar kritika ndaj punës së një institucioni apo bartësve të përgjegjësive në atë institucion, dhe sidomos kur një person i veshur me kompetenca ligjore për të vepruar nuk vepron.”*
17. Gjithashtu, parashtruesi shton se *“deklarata e kryetarit të gjykatës, si shprehje e lirë e mendimit, absolutisht ka qenë në funksion të ngritjes së autoritetit të Sistemit të Drejtësisë në Kosovë, e assesi me qëllim të denigrimit të ndonjë institucioni apo individi.”*
18. Parashtruesi, më tej, pretendon *“se ai, kundër vendimit i cili është marrë nga KGJK në procedurën administrative, sipas ligjit ka pasur mundësi që të shfrytëzojë mjetin juridik - ashtu që me padi të nis procedurën e konfliktit administrativ në Departamentin për Çështje Administrative që vepron brenda kompetencave lëndore dhe territoriale të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ... por për shkak faktit se ai udhëheq drejtpërsëdrejti edhe me Departamentin për Çështje Administrative ku cakton dhe largon gjyqtarët nga ky departament, ai nuk ka dashur të shfrytëzojë këtë mjet juridik”.*
19. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që:

"a) Kërkesa të konsiderohet e pranueshme.

b) Të caktohet masa e përkohshme ashtu që Vendimi i KGJK-së i dt. 6.07.2016 të lihet jashtë fuqisë deri në marrjen e vendimit definitiv nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

c) Të konstatohet se Vendimi i KGJK-së i dt. 6.07.2016 cenon lirinë e shprehjes të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës - neni 40. Të urdhëroi KGJK-në që Vendimin e dt. 12.07.2016 ta konsideroi si të pavlefshëm dhe si i tillë nuk prodhon asnjë efekt juridik.

d) Të urdhërojë KGJK-në që Gjykatën Kushtetuese ta njoftojë për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese."

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i plotëson kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"[...] 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

22. Gjykata i referohet edhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili përcakton:

"[...] Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

23. Gjykata, më tej, i referohet edhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar."

24. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë konteston vendimet e KGJK-së të cilat janë marrë në procedurën administrative e cila është zhvilluar para komisioneve kompetente të KGJK-së.

25. Gjykata, më tej, vëren se parashtruesi pas marrjes së vendimeve të KGJK-së i është drejtuar drejtpërdrejtë Gjykatës Kushtetuese nga e cila ka kërkuar vlerësimin kushtetues të vendimeve të KGJK-së lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, përkundër faktit se ai kishte në dispozicion edhe mjete të tjera juridike të përcaktuara me

ligj dhe me shfrytëzimin e të cilave ai mund t'i ketë mbrojtur të drejtat dhe liritë e tij.

26. Gjykata vëren se parashtruesi konsideron se vetë fakti që ai ka një pozitë specifike e cila "bart" me vete të drejta, obligime dhe përgjegjësi të caktuara, vetvetiu duhet ta lirojë atë nga shterimi i të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj dhe të cilat qëndrojnë në dispozicion të tij.
27. Gjykata thekson se kjo nuk mund të jetë arsye që parashtruesi i kërkesës të lirohet nga shterimi i mjeteve juridike duke marrë parasysh se me ligj është rregulluar mënyra se si zgjidhen kërkesat e tilla.
28. Gjykata rikujton se neni 113 i Kushtetutës rregullon juridiksionin dhe palët e autorizuara, ku në po këtë nen është specifikuar në detaje se në cilat raste, në çfarë rrethana dhe në bazë të çfarë kritereve palët e autorizuara mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.
29. Gjykata, më tej, thekson se parashtruesi i kërkesës në këtë rast është individ i cili hyn në radhën e palëve të autorizuara, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe si i tillë edhe do të jetë objekt i shqyrtimit.
30. Për më tepër, Gjykata rikujton se edhe aktet tjera ligjore, si dhe parimi i subsidiaritetit, kërkojnë që parashtruesit t'i shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë, apo të korrigjohen shkeljet eventuale të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
31. Gjykata dëshiron të theksojë se në rastin KI145/15 ka trajtuar një kërkesë të ngjashme dhe më 16 maj 2016 nxori aktvendimin për papranueshmëri, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike të cilat me ligj i kanë në dispozicion (aktvendimin për papranueshmëri: *Florent Muqaj, kundër vendimit nr. 321/2015 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KI145/15 të 5 nëntorit 2015*).
32. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve kompetente, duke përfshirë gjykatat e rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, Aktvendimin për papranueshmëri, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999*).
33. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se në këtë rast nuk ekziston një vendim përfundimtar i autoritetit kompetent, i cili në këtë fazë do të mund të ishte objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese.

Kërkesa për masë të përkohshme

34. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që Gjykata të vendosë masën e përkohshme me të cilën vendimet e KGJK-së do të shfuqizohen deri sa ajo të nxjerrë vendimin lidhur me këtë kërkesë.
35. Në mënyrë që Gjykata të vendosë masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, është e nevojshme që:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar (...), nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme, dhe [...]

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës.”

36. Siç u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet, si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (b) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 27 mars 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi